



FËMIJA IM RRITET ME SHUMË GJUHË

Këshilla për prindërit në lidhje me shumëgjuhësinë

E disponueshme gjithashtu në gjuhët:

Gjermanisht

Arabisht

Bullgarisht

Anglisht

Persisht

Frëngjisht

Kurdishte kurmanxhi

Polonisht

Rumanisht

Rusisht

Turqisht

Përmbajtja

Hyrje	5
Si është duke u zhvilluar gjuha e fëmijës sim?	6
Si mund ta mbështes zhvillimin gjuhësor të fëmijës sim?	7
Këshilla për zhvillimin e përgjithshëm të gjuhës	8
A është gjithçka në rregull me zhvillimin gjuhësor të fëmijës tim?	9
Kush është dygjuhësh/shumëgjuhësh?	10
Si mëson fëmija im shumë gjuhë?	11
Çfarë mund të ndodhë?	12
Kujdes! Përzjerje gjuhësh	12
Refuzim gjuhësh	12
Fillim i vonshëm i të folurit	12
Njëra gjuhë do të jetë më e fortë! – Gjuha dominuese	12
Çfarë është e rëndësishme kur mësoni shumë gjuhë?	13
Si mund ta mbështes shumëgjuhësinë e fëmijës tim?	14
Grupe shumëgjuhëshe prindër-fëmijë	15
Literatura	15

Të dashur prindër,



© Gebhard Bückler për Qarkun Viersen

shumë fëmijë në shoqërinë tonë flasin disa gjuhë në jetën e tyre të përditshme dhe rriten në një mjedis shumëgjuhësh. Për ju si prind, kjo mund të nënkuptojë që edukimi me shumë gjuhë luan një rol të madh te ju.

Në këtë situatë, prindërit shpesh pyesin veten se si duket zhvillimi normal i gjuhës me shumëgjuhësinë dhe si mund t'i mbështesin më së miri fëmijët e tyre.

Ky udhëzues ka për qëllim t'ju mbështesë në çështjet në lidhje me temën e edukimit shumëgjuhësh. Ai ofron njohuri të thjeshta për t'u kuptuar dhe jep këshilla të dobishme dhe universale për mbështetjen gjuhësore me shumëgjuhësi, të cilat mund të integrohen lehtësisht në jetën tuaj të përditshme familjare.

Shpresojmë që ky udhëzues t'ju shërbejë si i dobishëm.

Administratori juaj i qarkut

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Andreas Coenen'. The signature is fluid and cursive.

Dr. Andreas Coenen

Si është duke u zhvilluar gjuha e fëmijës tim?



Zhvillimi i gjuhës te fëmijët
Parafytyrje e thjeshtuar
0 – 5 vjeç

3 – 5 vjeç

- Moshë e dytë e pyetjeve: Pyetjet me pse
- Fjalitë me fjali të nënrenditura

2 – 3 vjeç

- Struktura dhe zhvillimi i gramatikës
- Fjalitë e thjeshta, lakimi i fjaleve

18 muaj – 2 vjeç

- Fjali dy- dhe shumëfjalëshe
- Moshë e parë e pyetjeve

1 vjeç – 18 muaj

- Fjali me një fjalë
- Emrat e njerëzve dhe të objekteve
- Dyfishimi i rrokjes dhe imitimi i tingullit

6 muaj – 1 vjeç

- Monologë tingujsh
- Imitimi i vetes dhe i të tjerëve

Nga lindja deri në rreth 1 vjeç

- Klithma e lindjes

Si mund ta mbështes zhvillimin gjuhësor të fëmijës sim?

- Ju jeni modeli më i rëndësishëm gjuhësor për fëmijët tuaj. Mënyra se si, çfarë dhe kur ju flisni - fëmijët e thithin të gjithë këtë qysh në mitër për ta imituar më vonë, për ta provuar dhe për t'i dhënë formë vetë.



Ilustrimi 1: Bazuar në bazën ndihmëse të piramidës së gjuhës



© JackF – stock.adobe.com

Prindërit janë një shembull gjuhësor për fëmijët e tyre!

Këshilla për zhvillimin e përgjithshëm të gjuhës

- Flisni me fëmijën tuaj sa më shumë që të jetë e mundur në gjuhën me të cilën ndiheni më mirë.
- Inkurajoni fëmijën tuaj të flasë sa më shumë dhe jepini atij mjaft kohë për të folur vetë. Lëreni fëmijën tuaj të flasë dhe mos e ndërprisni. Televizioni apo videot nuk mund ta zëvendësojnë këtë shkëmbim verbal. Jeta e përditshme ofron shumë mundësi për të komunikuar me fëmijën tuaj dhe për ta përfshirë në biseda.
- Flisni me fëmijën tuaj me fjali të shkurtra, të thjeshta, në gjuhën e folur (jo në «gjuhë foshnjesh"!)) dhe jo shumë shpejt. Përsëritni terma specifike, të cilat fëmija ende nuk i di.
- Mos qeshni kur fëmija juaj bën gabime gjuhësore, sado qesharake të tingëllojë kjo. Mos i korrigjoni gabimet, por përsërisni atë që u tha në mënyrë të saktë.
- Dëgjoni fëmijën tuaj dhe lëvdojeni atë!
- Lexoni një libër me fëmijën tuaj ose shkoni së bashku në bibliotekë dhe lëroni ata të zgjedhin libra që atyre i duken interesantë.



Ilustrimi 2: Parimet e përkrahjes gjuhësore

A është gjithçka në rregull me zhvillimin gjuhësor të fëmijës tim?

Ashtu si fëmijët që rriten në një gjuhë, edhe ata që rriten me shumë gjuhë mund të kenë probleme me zhvillimin e gjuhës. Probleme të tilla nuk lindin kurrë për shkak të mjedisit shumëgjuhësh. Kur diçka shkon keq, kjo shpesh ndërlidhet me faktorë të tjerë, të tillë si problemet e dëgjimit ose problemet neuropsikologjike.

Ju mund të dalloni problemet e mundshme, për shembull, nëse fëmija juaj:

- në ditëlindjen e parë, duket se i kupton pak fjalët, nuk tërheq vëmendjen për asgjë duke treguar me gisht ose nuk reagon në emrin e tij;
- në vitin e dytë të jetës nuk përpiqet të flasë vetë ose kupton vetëm pak disa fjalë;
- në vitin e tretë të jetës vetëm herë pas here formon fjali me dy fjalë ose mezi mëson ndonjë fjalë të re.

A mendoni se fëmija juaj ka probleme me zhvillimin e gjuhës? Se nuk di mjaftueshëm fjalë, ka probleme me shqiptimin dhe nuk mund të komunikojë në mënyrë adekuate me ata që e rrethojnë?

Merrni këshilla nga një ordinancë pediatrike ose një qendër këshillimi familjar.



©Robert Kneschke - stock.adobe.com

Kush është dygjuhësh/shumëgjuhësh?

- Një fëmijë është shumëgjuhësh kur ai mund të komunikojë aktivisht në më shumë se një gjuhë në jetën e përditshme.
- Rritja në një mjedis shumëgjuhësh i ofron fëmijës suaj një mundësi të shkëlqyer.
- Truri i fëmijës mund të mësojë disa gjuhë në të njëjtën kohë pa u mbingarkuar. Sa më herët që fëmija të ndeshet me një gjuhë të re, aq më lehtë është për ta mësuar atë.


Çdo fëmijë e mëson gjuhën e tij individualisht.

Disa fëmijë kanë nevojë për pak më shumë kohë.


Jepini fëmijës tuaj kohë dhe jini të durueshëm!

Si mëson fëmija im shumë gjuhë?

- **Njëkohësisht** - përvetësimi i njëkohshëm i gjuhës - kur një fëmijë mëson dy ose më shumë gjuhë që nga lindja.



- **Në mënyrë të njëpasnjëshme** - përvetësimi i njëpasnjëshëm i gjuhës - kur një fëmijë mëson një gjuhë të dytë ose të tretë, rreth moshës tre vjeçare. Do të thotë, gjuha e dytë ose e tretë mësohet pas gjuhës së parë.





©Robert Kneschke - stock.adobe.com

Çfarë mund të ndodhë?

Kujdes! Përzierje gjuhësh

- **Fëmijët i përziejnë dhe i ndërrojnë gjuhët e tyre.** Nuk është e pazakontë që fëmijët të bëjnë gabime të caktuara në fillim kur mësojnë një gjuhë të re. Këto gabime shpesh tregojnë se fëmijët janë në rrugën e duhur për gjuhën gjermane.

Refuzim gjuhësh

- Disa familje raportojnë se ka faza në të cilat fëmijët flasin vetëm gjermanisht dhe refuzojnë të përdorin gjuhën e familjes. Kjo nuk është arsye për t'u shqetësuar.
- Vazhdoni të flisni në gjuhën tuaj me fëmijën tuaj vazhdimisht. Edhe si dëgjues, fëmija juaj mund ta zhvillojë gjuhën tuaj dhe sigurisht që do ta flasë përsëri më vonë.

Fillim i vonshëm i të folurit

- Në rastin e shumëgjuhësisë, është normale të filloni të flisni midis muajit të 14-të dhe të 16-të të jetës.

Njëra gjuhë do të jetë më e fortë! – Gjuha dominuese

- Nëse gjuhët janë të ngjashme dhe përdoren po aq shpesh, gjuhët zhvillohen në të njëjtën kohë.
- Nëse gjuhët janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, atëherë gjuhët zhvillohen ndryshe: gjuhë e fortë dhe gjuhë e dobët.



Çfarë është e rëndësishme kur mësoni shumë gjuhë?

SHUMË KONTAKT me gjuhët!

- Sa **MË HERËT** të jetë e mundur.
- Sa **MË SHPESH** të jetë e mundur.

Jepni **SHUMË SUGJERIME!**

- Krijoni mundësi gjuhësore në jetën e përditshme.
- Bëni vizita në vendin tuaj të origjinës ose jashtë vendit.
- Festoni festivale të organizuara dhe takoni njerëz që flasin gjuhën tuaj si gjuhë të parë.
- Pjesëmarrja në grupe lojërash apo festa për fëmijë ku fëmijët flasin të njëjtën gjuhë mes tyre.



©Robert Kneschke – stock.adobe.com

Si mund ta mbështes shumëgjuhësinë e fëmijës tim?

- **Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën tuaj amtare.** Si nënë apo si baba, flisni gjithmonë me fëmijën tuaj në gjuhën që është më e mira për ta qetësuar atë, për ta ngushëlluar dhe për të treguar dashuri.
- **Në rastin e dygjuhësisë brenda familjes, krijoni “rregulla gjuhësore” të qarta.** Mos ndërroni dhe mos përdorni gjuhët në familje në mënyrë të rastësishme: Është e rëndësishme që fëmija juaj të jetë në gjendje të ndërlihdë një gjuhë të caktuar me situata të caktuara ose me një person të caktuar, për shembull, të flaë turqisht me nënën, ndërsa gjermanisht me babain.
- **Jepini fëmijës tuaj mundësi të hershme dhe të shpeshta për të përjetuar dhe përdorur gjuhën e tyre të dytë.** Gjuha e dytë është më e lehtë për t'u mësuar në kushte të përditshme – në shesh lojërash, me miqtë në shtëpi ose në kopshtin e fëmijëve.
- **Vizitat e rregullta në çerdhe ndihmojnë në mësimin e gjermanishtes!** Nëse fëmija juaj nuk flet ende gjermanisht kur hyn në çerdhe, vazhdoni t'i flisni në gjuhën tuaj amtare. Kjo do ta ndihmojë fëmijën tuaj të përvetësojë gjuhën në gjuhën e tij të parë. Në të njëjtën kohë, jepini fëmijës suaj mundësi të mjaftueshme për të luajtur me fëmijët gjermanishtfolës jashtë qendrës ditore, në mënyrë që ata të mësojnë mirë gjermanishten.
- **Lexojini fëmijës tuaj në të dyja gjuhët shpesh!** Merrni libra në gjuhët përkatëse.
- **Jepini fëmijës tuaj një qëndrim pozitiv ndaj shumëgjuhësisë së tij:** Mund të bëjë diçka që të tjerët nuk munden, është një hap përpara tyre.
- **Kërkoni oferta në mjedisin tuaj!** Sa më shumë të jetë i ekspozuar fëmija juaj ndaj një gjuhe, aq më mirë do të mësojë.
- **Zgjidhni media të mira elektronike si televizioni, DVD-të, CD-të, radio, tabletët dhe telefonat inteligjentë,** dhe për rrjedhojë edhe internetin. Kohëzgjatja e përdorimit këtu është shumë e rëndësishme.

Grupe shumëgjuhëshe prindër-fëmijë



I dobishëm

- Program edukimi familjar për prindërit dhe fëmijët e tyre nga 0 deri në 3 vjeç.
- Promovimi i shumëgjuhësisë përmes aktiviteteve për fëmijë.



Çantë shpine KiTa

- Program edukimi familjar për prindërit dhe fëmijët e tyre nga moshën 4 deri në 6 vjeç, të cilët ndjekin një qendër ditore.
- Promovimi paralel i gjuhës së familjes dhe gjuhës përreth.

Për më shumë informacion, kontaktoni qendrën komunale të integrimit të rrethit Viersen në 02162 39-1961 ose dërgoni një email në felicia.bot-jurca@kreis-viersen.de.

Literatura

Më poshtë gjeni literaturën, të cilës iu kemi referuar në këtë udhëzues.

- Abdelilah-Bauer, B. (2012). Zweisprachig aufwachsen: Herausforderungen und Chance für Kinder, Eltern und Erzieher (3.Auflage 2016). München: Verlag C.H. Beck
- Burkhardt Montanari, E. (2000). Wie Kinder mehrsprachig aufwachsen: Ein Ratgeber. (7.Auflage 2020). Frankfurt am Main: Brandes & Apsel Verlag
- Chilla, S. und Fox-Boyer, A. (2012). Zweisprachigkeit/Bilingualität: Ein Ratgeber für Eltern. (2. Auflage 2016). Idstein: Schultzt-Kirchner Verlag
- Goethe-Institut, Sprachabteilung. Kinder entdecken Deutsch: Eine Broschüre für Eltern und Pädagogen. Warschau
- Haid, A. (2012). Kindlicher Spracherwerb: Kinder lernen sprechen, Informationsbroschüre. (2. Auflage 2012).
- Hilfswerk, Österreich. (2020). Sprechen macht schlauer: Wie Kinder fürs Leben lernen. Mattersburg: Wograndl
- Hricova, M. (2021). Sprachförderung bei Mehrsprachigkeit: Ein Ratgeber für Eltern, Pädagogen und Therapeuten. Idstein: Schultzt-Kirchner Verlag
- Jimenez, M.I. (2015). Mit Sprache umhüllen: Praktische Tipps für die bilinguale Erziehung. Pulheim: Schau Hör Verlag
- Land Niederösterreich, Amt der NÖ Landesregierung. (2020). Sprich mit mir und hör mir zu!: Eine Broschüre für Eltern, 12 Anregungen wie wir unsere Kinder beim Sprachenlernen unterstützen können 0 – 6 Jahren. St. Pölten: Amtsdruckerei
- Leist-Villis, A. (2008). Elternratgeber Zweisprachigkeit: Informationen & Tipps zur zweisprachigen Entwicklung und Erziehung von Kindern. (7. Auflage 2016). Tübingen: Stauffenburg Verlag
- Nodari, C. und De Rosa, R. (2003). Mehrsprachige Kinder: Ein Ratgeber für Eltern und andere Bezugspersonen. (2. Auflage 2006). Bern: Haupt Verlag
- okay. zusammen leben, Projektstelle für Zuwanderung und Integration. (2010). Sprich mit mir und hör mir zu! 12 Anregungen wie wir unsere Kinder beim Sprechenlernen unterstützen können: Eine Broschüre für Eltern. Dornbirn: VVA, Vorarlberger Verlagsanstalt
- Triarchi-Herrmann, V. (2011). Mehrsprachige Erziehung: Wie Sie Ihr Kind fördern. (3. Auflage 2012). München: Ernst Reinhardt Verlag
- Universitätsstadt Tübingen, Gleichstellung und Integration. (2012). Mehrsprachig aufwachsen: Ein Gewinn für Bildung. Informationen für Eltern und Lehrkräfte. Interne Dienste

Qarku Viersen

Zyra për Mirëqenie Sociale – Qendra Komunale për Integrim

Rathausmarkt 3 | 41747 Viersen

www.kreis-viersen.de

Financuar nga:

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Impresum

Botuesi: Qarku Viersen – Administratori i Qarkut

Redaksia: Qendra Komunale për Integrim

Redaktimi: Zyra për Shtyp

Dizajni: Zyra për Shtyp

Shtypi: Qendra e shtypit Qarku Viersen

Data: Janar 2022

Fotot: ©Qarku Viersen – përveç nëse shënohet ndryshe

Infografika: ©Qarku Viersen – Qendra Komunale për Integrim

